



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1321 / Prot. 12

Vlorë, më 07.07.2023

VENDIM

Nr 34, datë 06.07.2023

**PËR  
SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.26 TË SENATIT AKADEMIK, DATË 01.07.2019 "PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMËRTIMIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE  
HUMANE NË FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË"**

Në mbështetje të nenit 33 pika 1, 38 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, nenit 113 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" si dhe referuar propozimit të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ardhur me shkresën nr.1295/1, prot, datë 04.07.2023, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.07.2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratoje propozimin e Rektorit për shfuqizimin e Vendimit nr.26, të Senatit Akademik "Për miratimin e ndryshimit të emërtimit të Fakultetit të Shkencave Humane në Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë".
2. Emri i kësaj njësie kryesore do të qëndrojë "Fakulteti i Shkencave Humane".
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi "Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë", Zëvendësrektori Akademik, Drejtorja e Ciklit të I dhe të II të studimit".
4. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETRI I SENATIT AKADEMIK  
Prof. Dr. Roland Zisi**

